



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

KRYETARI

URDHËR

Nr. 28547/1 datë 17.7 2019

**PËR
NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM
VENDOR TË BASHKISË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 23, pika 14, nenit 64, shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 13, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, nenit 12, të vendimit nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar, vendimit nr. 1, datë 14.04.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Tiranë", udhëzimit nr. 1, datë 22.02.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar", si dhe në vijim të Vendimit të kryetarit të Bashkisë për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e planit të përgjithshëm vendor (PPV) të Bashkisë Tiranë nr. 28547 datë 17.07.2019,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, me përbërjen si më poshtë:

Drejtor i DPPZhT: Z. Ditjon Baboçi, kryetar

Drejtor i DPT: Anisa Mançe, anëtar ✓

Drejtor DTTRR: E. Punavija, anëtar

Përgjegjës i SM: Z. Devis Agaraj, anëtar

Përgjegjës i SGIS: Znj. Elda Maçi, anëtar

Specialist i DPPZhT: Mirlinda Shqarri, anëtar
Specialist i DPPZhT: Iva Tavanxhiu, anëtar
Specialist i DPPZhT: Arlind Okaj , anëtar
Specialist i DPPZhT: Gjergj Papavasili, anëtar
Specialist i DPPZhT: Soviela Shehu, anëtar

2. Grupi i punës, i përcaktuar në pikën 1, të këtij urdhri, të kryejë detyrat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi që rregullon rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor nëpërmjet procedurës së thjeshtuar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion VELIAJ

